



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e teknologjisë së informacionit ushtruar në Agjencinë
Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR

AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

Tiranë, shtator 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	5
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve	6
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	7
7.	Metodat e auditimit	7
8.	Dokumentimi i auditimit	8
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Auditimi i Sigurisë së Informacionit	9-16
2.2	Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit	16-24
a	Investimet në drejtim të teknologjisë së informacionit dhe Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.	
2.3	Auditimi i sistemit informatik mbi të dhënat Input/Output	24-31
IV.	REKOMANDIME	32-39

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore - AKBPM, nga data 23.04.2024 deri në 10.07.2024.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit. Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në AKBPM, është pjesë e Planit Vjetor 2024 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që janë zhvilluar në AKBPM.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 478/2, me datë 18.04.2024.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se nuk ka një akt krijimi të bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), që do të thotë se nuk është bërë një identifikim i të dhënave parësore të këtij sistemi, si dhe të dhënave dytësore që nevojiten për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij. Për këtë bazë të dhënash, nuk janë përcaktuar sipas nenit 4 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”:
 - a) institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore;
 - b) të dhënat parësore dhe dytësore;
 - c) dhënësin/dhënësit e informacionit;
 - ç) ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;
 - d) nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.
- Infrastruktura *Software* dhe *Hardware* ku është ngritur Sistemi i Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), deri në fund të vitit 2022, ka qenë e konsideruar Infrastrukturë Kritike e informacionit, bazuar në VKM nr. 553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, që i përket periudhës objekt auditimi. Me hyrjen në fuqi të ndryshime me VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, sistemi tashmë i përmirësuar me emrin “Sistemi i Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, nuk rezulton të jetë në listën e infrastrukturave kritike apo të rëndësishme të informacionit, megjithëse rëndësia e tij është e lartë nisur nga fakti që cenimi apo shkatërrimi i tij do të kishte impakt serioz në shëndetin e qytetarëve.

- Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nuk ka strukturë të posaçme (sektor TIK) apo punonjës IT në organikën e saj, të cilët kanë fushën e ekspertizës në çdo sistem dhe infrastrukturë *hardware* dhe *software* në fushën TIK të institucionit. Për më tepër, pranë AKBPM, aktualisht nuk ka asnjë specialist IT të atashuar nga AKSHI që prej fundit të Qershorit 2023, duke vështirësuar përmbushjen e detyrimeve në fushën TIK. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të AKBPM-së dhe korrespondencës zyrtare AKBPM – AKSHI, nga muaji Korrik 2023 e deri në periudhën e kryerjes së auditimit, ende nuk ka një asistencë teknike të atashuar nga AKSHI për Agjencinë. AKSHI i ka komunikuar AKBPM-së se ka kryer shpalljen e vendit vakant përcjellë me shkresën nr. 3361/7 prot., datë 16.11.2023, për përmbushjen e nevojave për burime njerëzore pranë AKBPM. Shkresa e fundit është me nr.1894 prot., datë 16.05.2024 ku kërkohet sërish nga ana e AKBPM-së caktimi i një punonjësi IT për periudhën tranzitore deri në plotësimin e vendit vakant. Mosplotësimi i vendeve vakante dhe punonjësve në një fushë kyçe si IT mbart riskun e lartë të mospërmbushjes së objektivave dhe misionit për të cilin është ngritur institucioni i AKBPM.
- Nga auditimi u konstatua se për AKBPM nuk është hartuar asnjë politikë, manual apo udhëzues mbi sigurinë e informacionit, me objekt përcaktimin e parimeve dhe rregullave të përgjithshme të sigurisë së informacionit dhe përcaktimin e përgjegjësive për veprimet që lidhen me sigurinë me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aseteve të informacionit në AKBPM. Siguria e informacionit është një çështje që kërkon një bashkëpunim të ngushtë midis AKBPM-së dhe AKSHI-t. Edhe pse infrastruktura TIK dhe politikat e sigurisë së informacionit janë përgjegjësi primare e AKSHI-t, sikurse përcakton dhe neni 27 i Ligjit nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, është thelbësore që AKBPM të ketë një rol aktiv në këtë proces për të siguruar që të gjitha kërkesat specifike të sigurisë për informacionin që administrojnë të jenë të përmbushura. Në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 26, të Ligjit nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, AKSHI administrojnë nga ana teknike sistemin informatik të institucioneve në varësi të Këshilli të Ministrave, ndërkohë që regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve përkatëse. Mungesa e politikave, manualeve dhe udhëzuesve mbi sigurinë e informacionit për AKBPM rrit ndjeshëm riskun për incidente sigurie, siç janë akseset e paautorizuara, humbja ose komprometimi i të dhënave, si dhe mungesa e përgjegjësive të qartë për veprimet e sigurisë, duke cenuar integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e aseteve të informacionit në AKBPM.
- Nga auditimi u konstatua se AKBPM nuk ka dijeni për listën e përdoruesve të brendshëm, të jashtëm dhe të bazës së të dhënave të Sistemit të Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), të drejtat e tyre, si dhe akseset specifike për secilin prej tyre. Ky informacion u kërkua tek struktura IT e AKSHI-t, vendosur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët gjithashtu, nuk kishin dijeni. Mungesa e këtij informacioni dhe kontrolli cenon integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave që ruhen në sistemin informatik të barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucioni koordinator për bazat e të dhënave shtetërore, të marrë masa për përgatitjen dhe miratimin e një akti nënligjor për krijimin e bazës së të dhënave për Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), në bashkëpunim me AKBPM, ku të përcaktohen të dhënat parësore dhe dytësore, burimet e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit t’i kërkojnë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike - AKSK,

të bëjë ndryshimet përkatëse në VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, duke riklasifikuar si Infrastrukturë Kritike të Informacionit “Sistemin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB)”, duke marrë parasysh rëndësinë që ky sistem ka në shëndetin e qytetarëve. Me klasifikimin e duhur nevojitet të përmirësohen masat e sigurisë, të zbatohen protokolle të avancuara për mbrojtjen e të dhënave dhe të trajnohet vazhdimisht personeli për menaxhimin e situatave emergjente dhe kërcënimeve kibernetike.

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për caktimin e një punonjësi të Teknologjisë së Informacionit për të mbuluar nevojat e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore deri në plotësimin e vendit vakant të shpallur.
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për të hartuar politikat e sigurisë së informacionit për AKBPM, si institucioni qendror për administrimin e infrastrukturës hardware dhe software dhe shërbimeve të ndryshme në fushën TIK ku përfshihet dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore..
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për të ndërtuar procese kontrolli dhe monitoruar nëpërmjet tyre krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e aksesit në sistemin informatik të përdoruesve të brendshëm, si dhe atyre me akses në bazën e të dhënave. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të marrë masa për të siguruar informacionin e nevojshëm mbi përdoruesit që janë punonjës të institucionit.

3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, rezultoi se për Sistemin i Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore paraqiten disa mangësi që kërkojnë vëmendje të menjëhershme nga:

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucioni përgjegjës për administrimin, krijimin, kontraktimin e shërbimeve, si dhe përmirësimin e infrastrukturës TIK;
- Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike, si institucioni përgjegjës për Sigurinë Kibernetike;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si institucioni monitorues i AKBPM-ës.

Mungesa e krijimit të bazës së të dhënave shtetërore, së bashku me heqjen e statusit “Infrastrukturë Kritike e Informacionit”, përbëjnë risk të lartë në mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit, për arsye se ky sistem është jashtë vëmendjes dhe i pamonitoruar ndaj sulmeve dhe keqpërdorimeve.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nuk mund të bëjë asnjë përmirësim të situatës e vetme dhe në kushtet në të cilat ndodhet, ku mungojnë:

- Udhëzime specifike për sigurinë e informacionit;
- Strukturat e dedikuara nga AKSHI për IT;
- Një pozicion i dedikuar në strukturë për administrimin e të dhënave, megjithëse përgjegjëse për këto të dhëna;

Kjo mungesë vëmendje, kontrolli dhe mbikëqyrjeje cenon 3 parimet themelore të sigurisë së të dhënave: konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë; duke e vendosur institucionin në mundësinë e krijimit të problemeve serioze në rastet e ndonjë incidenti të sigurisë ose keqpërdorimi të sistemit.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 478/2 prot., datë 18.04.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 23.04.2024 deri më datë 10.07.2024, në subjektin “AKBPM”, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjëse grupi;
2. D. B., anëtar.

1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në AKBPM, nga data 23.04.2024 deri më datë 10.07.2024. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e AKBPM arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e informacionit që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve të AKBPM.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 478/2 Prot, datë 18.04.2024:

1. Auditimi i Sigurisë së Informacionit.
2. Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit.
 - a. Investimet në drejtim të teknologjisë së informacionit dhe Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.
3. Auditimi i sistemit informatik mbi të dhënat Input/Output.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me hyrjen në fuqi të ligjit të barnave nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, përfaqëson një institucion të specializuar për analizën, kontrollin dhe regjistrimin e barnave dhe ushtron veprimtarinë e saj nën varësinë e Ministrinë të Shëndetësisë.

Fokusi i agjencisë është të:

- Ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e detyrimeve që lidhen me farmakovigjilencën;
- Miratojë, sipas rregullave të parashikuara në ligj, formatin e publicitetit për barnat;
- Bashkëpunojë me institucione analoge jashtë vendit si dhe institucione të tjera brenda vendit, për çështje të ndryshme të fushës farmaceutike dhe të pajisjeve mjekësore;
- Propozojë, pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore, me qëllim plotësimin dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës;
- Kryejë procesin e regjistrimit bazuar në standardet e parashikuara, për pajisjet mjekësore;
- Zhvillojë procesin e inspektimit për barnat dhe pajisjet mjekësore, në përputhje me aktet ligjore dhe ato nënligjore.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi AKBPM mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 31.12.2023, në drejtim të teknologjisë së informacionit, që është në përdorim dhe i shërben institucionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr.478/2 Prot., datë 23.04.2024 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon AKBPM si dhe legjislacionin për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7975 “Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope”;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”; Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”;
- Ligji nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, etj;
- VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet Ndërkombëtare në Teknologjinë e Informacionit;
- Standardet TIK, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testimet dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullator të institucionit;
- Shqyrtimi i dokumenteve rregullatorë të përdorimit të sistemeve informatike;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Analizimi i funksioneve të sistemit dhe të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e specializuar për analizën dhe kontrollin e barnave, për dhënien e autorizimit për tregtim, për inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, për farmakovigjilencën dhe për administrimin e standardeve të pajisjeve mjekësore.

Aktiviteti operacional i AKBPM-ës bazohet në pjesën më të madhe të tij në Sistemin Informatik të Regjistrimit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Sistemi i informacionit të regjistrimit dhe kontrollit të barnave-SIRKB është prokuruar në vitin 2014 nga Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e organit qendror blerës. Kontrata me nr.4059/2prot., datë 8.7.2014 është nënshkruar nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Në vitin 2021, AKSHI ka nisur hartimin e specifikimeve teknike për përmirësimin e infrastrukturës së këtij sistemi ku AKBPM ka kontribuar me funksionalitete të sistemit si dhe Ëorkfloë të funksionimit të sistemit dhe në vitin 2022 është kontraktuar shërbimi nga AKSHI si Autoritet Kontraktor dhe AKBPM do të ishte jo vetëm Autoritet Përfitues por dhe Autoriteti Pagues i këtij shërbimi, që kishte për qëllim rinovimin e pajisjeve fizike, shtimin e funksionaliteteve për regjistrimin dhe autorizimin e Pajisjeve Mjekësore, si dhe përmirësime të nevojshme të funksionaliteteve që përdoren për Barnat dhe në funksion të tyre.

Ndërprerja apo mosfunksionimi i këtij sistemi, përbën një risk të lartë në shëndetin e qytetarëve për shkak të procesve të ndërlidhura me importin, etiketimin dhe autorizimin për shpërndarjen e barnave në spitale dhe në rrjetet farmaceutike.

2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i Sigurisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 1 “Auditimi i sigurisë së informacionit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Akte ligjore/nënligjore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij, ndër të cilat:
- Ligji Nr.105/2014 “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik” i ndryshuar;
- VKM Nr.24, datë 14.1.2015 “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit të organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, ndryshuar;
- Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, miratuar me Urdhër të Brendshëm Nr.264, datë 25.9.2017 të Drejtorit të AKBPM-së;
- VKM Nr.184, datë 9.3.2016 “Për Përcaktimin e Rregullave për Ushtrimin e Kontrollit për Veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, në zbatimin e Detyrave dhe Ushtrimin e Përgjegjësive nga kjo Agjenci”;
- Manual përdoruesi për subjektet – Barnat;
- Manual përdoruesi për subjektet – Pajisjet mjekësore, etj.

➤ *Mbi vlerësimin e Burimeve Njerëzore*

Për kryerjen e funksioneve të saj, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ka një strukturë organizative të miratuar me VKM Nr.24, datë 14.1.2015 “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit të organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, ndryshuar. Agjencia është e ndërtuar mbi bazën e sektorëve dhe

udhëhiqet nga një Drejtor, i cili ka në varësi dy nëndrejtorë: atë ekonomik dhe teknik. Veprimtaria e saj rregullohet nëpërmjet përshkrimeve të punës miratuar me Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Agjenci Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”.


Numri i përgjithshëm i stafit të AKBPM është gjithsej 99 punonjës. Vlen të theksohet se AKBPM ia ka kaluar AKSHI-t strukturën e vet TIK sipas VKM nr. 673/2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, por në mungesë të një marrëveshjeje bashkëpunimi të detajuar për shërbimet që AKSHI u ofron. Sipas kësaj VKM, strukturat përgjegjëse TIK bëhen pjesë të strukturës së AKSHI-t. Funksionet që kanë punonjësit e TI dhe nevojat brenda institucionit duhet të mbulohen të gjitha nga një specialist IT i jashtëm, pjesë e strukturës së AKSHI-t.

Nga auditimi mbi burimet njerëzore u konstatua se AKBPM nuk ka një strukturë të posaçme apo punonjës IT në organikën e saj. Për më tepër, vendi i specialistit IT që duhet të mbulojë nevojat e AKBPM është ende vakant që prej fundit të qershorit të vitit 2023. AKBPM ka patur korrespondencë zyrtare të vazhdueshme me AKSHI-n për emërimin/caktimin e një personi IT që të mbulojë nevojat e institucionit. Shkresa e fundit e dërguar në lidhje me këtë çështje i përket datës 16.05.2024, me nr. 1894 prot., ku kërkohet sërish caktimi i përkohshëm i një punonjësi IT pranë AKBPM-së për periudhën tranzitore deri në plotësimin e vendit vakant. Kjo shkresë ka pasuar komunikimet zyrtare të mëposhtme:

- Shkresën nr. 2499/4 prot., datë 19.9.2023 të AKBPM dhe përgjigjen e AKSHI-t me shkresën nr. 3361/5 prot., datë 20.10.2023;
- Shkresën nr. 2499/6 prot., datë 27.10.2023 të AKBPM dhe përgjigjen e AKSHI-t me shkresën nr. 3361/7, datë 16.11.2023.

Në përgjigjen e tyre, AKSHI i ka komunikuar AKBPM se ka marrë masat për shpalljen e pozicionit vakant për përmbushjen e nevojave për burime njerëzore pranë AKBPM.

Kështu, organigrama e institucionit paraqitet si më poshtë:



Strukturat përbërëse të Agjencisë janë drejtoria (e cila është vetë Agjencia) si struktura më e lartë organizative, si dhe sektorët përkatës.

➤ *Mbi politikat e sigurisë së informacionit*

Grupi i auditimit shqyrtoi nëse subjekti ka një drejtim strategjik dhe mbështetje të mjaftueshme për sigurinë e informacionit sa i përket politikave të sigurisë, mbulimit të tyre, ndërgjegjësimit brenda subjektit dhe përputhshmërisë. Në këtë aspekt, subjekti u auditua nëse:

- ka politika apo strategji të sigurisë së informacionit;
- ato janë zbatuar dhe dokumentuar siç duhet;
- ato formojnë një plan të qëndrueshëm dhe kompakt të sigurisë së informacionit.

Grupi i auditimit ka konstatuar se AKSHI, si institucioni të cilit i është transferuar struktura dhe shërbimet e IT dhe me përgjegjësi primare, si dhe AKBPM, si institucion që duhet të bashkëpunojë me AKSHI-n për të siguruar që politikat e sigurisë të adresojnë specifikat dhe nevojat e saj të veçanta, nuk kanë hartuar dokumente politike ose strategjike në lidhje me sigurinë e informacionit. Kjo mbart riskun e mungesës së një drejtimi strategjik dhe udhëzimi të qartë brenda institucionit për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Mungesa e këtyre politikave sjell, gjithashtu, pamundësi dhe paaftësi për të identifikuar, menaxhuar dhe zbutur risqet në mënyrë efektive. Në mungesë të masave të përcaktuara qartë, infrastruktura e IT-së është më e ekspozuar ndaj sulmeve dhe incidenteve të sigurisë.

Menaxhimi i incidenteve dhe problemeve ka si qëllim të zgjidhë çështje, nëpërmjet investigimit dhe me analiza të thella, të incidenteve të mëdha ose të përsëritura, për të gjetur shkakun e ndodhjes. Pasi problemi është identifikuar dhe është kryer analiza e gjetjes së shkakut, ai shndërrohet në gabim të njohur ose joeficient dhe më tej duhet të zhvillohet një zgjidhje për ta trajtuar atë dhe për të parandaluar përsëritjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

Në lidhje me këtë pikë, nga auditimi u konstatua se për AKBPM nuk është hartuar asnjë manual apo udhëzues për sigurinë e informacionit, me objekt përcaktimin e parimeve dhe rregullave të përgjithshme të sigurisë së informacionit dhe përcaktimin e përgjegjësiave për veprimet që lidhen me sigurinë me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aseteve të informacionit në AKBPM.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKBPM dërguar me shkresën nr.1407/12, datë 28.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/5, datë 30.08.2024:

Së pari, Kundërshtimet me shkrim të subjektit të audituar pavarësisht argumentimit ligjor dhe provave shkresore që disponon Agjencia, nuk janë marrë në konsideratë nga grupi i auditimit sepse nuk janë bazuar në argumentime ligjore.

Së dyti, pretendimet pjesore ose të veçuara, të cilësuar prej grupit, nuk janë arsyetuar sipas ligjit, por në përmbledhje është shprehur qëndrimi i përsëritur i grupit sipas gjetjeve dhe përfundimeve të arritura prej tyre në Aktkonstatimet e datës 10.07.2024. Në këto kushte, subjekti i audituar i qëndron pretendimeve ligjore përcjellë me shkrim për aktkonstatimet 1, 2 dhe 3, respektivisht me shkresat nr.1407/7, 1407/8 dhe 1407/9, datë 17.07.2024.

Cështjet prioritare që nevojiten të zbatohen nga subjekti i audituar kanë të bëjnë me: “Politikat e sigurisë së informacionit”, bazuar në VKM nr.673, datë 22.11.2017, menaxhimi i sigurisë së informacionit është pjesë e fushës së ekspertizës së AKSHI-t, për më tepër që

AKBPM nuk ka në përbërje të saj struktura të specializuara në TIK e si pasojë nuk e ka të mundur të iniciojë apo të kryejë një rol aktiv në respektimin e këkresave dhe standardeve të sigurisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se një pjesë e mirë e rekomandimeve afektohen nga ndryshimet ligjore të propozuara për riklasifikimin e infrastrukturës së sistemit SIRKB, si një infrastrukturë kritike, në të cilën do të përcaktohet dhe Operatori Administrues, si dhe caktimi i strukturës TIK që do ti përgjigjet AKBPM-s për teknologjinë e informacionit.

Argumentimi i kësaj çështje vijon pas observacionit të AKSHI-t.

➤ *Mbi identifikimin dhe menaxhimin e risqeve IT*

Regjistri i Riskut përbën një dokument të projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontroleve) dhe riskun pas kontroleve duke evidentuar gjithashtu nevojën për kontrole të mëtejshme. Objektivi i kësaj nënpike auditimi ishte vlerësimi nëse të gjitha risqet e lidhura me sigurinë e informacionit janë identifikuar dhe nëse ekziston një strategji e përshtatshme nga ana e institucionit për adresimin, menaxhimin dhe minimizimin e tyre. Për këtë arsye, grupi i auditimit shqyrtoi nëse subjekti zotëron dokumentacion për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, me qëllim që të:

- kuptojë rolin e subjektit në procedurat e vlerësimit të risqeve;
- identifikojë cilat persona/struktura janë të përfshira në vlerësimin e risqeve;
- verifikojë nëse vlerësimi i risqeve kryhet dhe dokumentohet në mënyrë të rregullt, ose sa herë që ndryshojnë kushtet.
- verifikojë nëse konfigurimi aktual i sistemit është dokumentuar, duke përfshirë lidhjet me sistemet e tjera.
- verifikojë nëse dokumentacioni përmban përshkrime të risqeve kryesore për sistemin, mjedisin dhe infrastrukturën e subjektit.

Nga auditimi u konstatua se subjekti nuk ka asnjë regjistër rrisiku ku të jenë identifikuar risqet e lidhura me sigurinë e informacionit dhe objektivat e sipërpërmendura. Kjo mungesë e dokumentacionit e bën të pamundur vlerësimin e efektivitetit të kontroleve ekzistuese dhe planifikimin e masave të nevojshme për përmirësimin e sigurisë. Për rrjedhojë, subjekti mbetet i ekspozuar ndaj risqeve të paidentifikuara dhe të pamenaxhuara. Standardi ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001:2013 kërkon që institucionet të kryejnë një vlerësim të risqeve të sigurisë së informacionit dhe të mbajnë një regjistër të risqeve. Kjo ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve në mënyrë sistematike dhe të dokumentuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKBPM dërguar me shkresën nr.1407/12, datë 28.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/5, datë 30.08.2024:

Hartimi dhe implementimi i riskut si kërkesë e standardit ISO/IEC 27001:2013, nuk është në fushën e përgjegjësisë së AKBPM-s, por e AKSHI-t në zbatim të VKM nr.673, datë 22.11.2017. i cili është administrator i sistemit SIRKB dhe me ekspertizën e nevojshme për të zbatuar standardet ndërkombëtare. AKBPM në mungesë të strukturës TIK nuk mund të realizojë identifikimin teknik të risqeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ndryshimet ligjore të propozuara për riklasifikimin e infrastrukturës së sistemit SIRKB, si një infrastrukturë kritike, në të cilën do të përcaktohet dhe Operatori Administrues, AKBPM nevojitet të identifikojë risqe operationale me të dhënat që hidhen dhe administrohen në sistemin SIRKB, në përputhje me detyrimet e Ligjit Nr. 10296, date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “.. bejme me dije se lidhur me kete rekomandim te grupit te auditimit detyrat dhe pergjegjesite ligjore dhe administrative te Agjencise Kombetare te Shoqerise se Informacionit percaktohen ne Ligjin Nr. 43/2023 "Per Qeverisjen Elektronike". Detyrat e percaktuara ne bazen ligjore dhe rregullatore ne fuqi per njesine TIK te AKSHI-t, te atashuar prane MSHMS lidhen vetem me aspektin teknik te mirefunksionimit te sistemeve te teknologjise se informacionit, nderkohe qe persa i perket aspektit administrativ dhe politikave menaxheriale institucionale ato jane teresisht detyrim i vete njesise, ne rastin konkret te Agjencise Kombetare te Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore... Si rrjedhim baza ligjore ne fuqi, parashikon qe menaxhimi i riskut institucional eshte ne tagrin e vete institucionit. AKSHI zbaton bazen ligjore per menaxhimin e risqeve te tij institucionale, nderkohe menaxhimi i riskut te AKBPM nuk eshte pergjegjesi dhe as e drejte e AKSHI.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve kërkohet në Standardet Ndërkombëtare të sigurisë së informacionit ISO27001:2022, konkretisht në kontrollin 5.19, kapitulli Kontrolllet Organizative.

Për këtë arsye, grupi i auditimit ka ndarë përgjegjësitë në lidhje me këtë çështje duke specifikuar çfarë risqesh identifikohen dhe ndiqen nga AKSHI dhe çfarë nga AKBPM. Rekomandimi është detajuar për të qenë sa më i kuptueshëm për të dyja palët.

➤ *Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat*

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së aktivitetit të institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe përditësimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar se ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Biznesit (Business Continuity Plan). Vazhdimësia e biznesit (BCP) është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje.

Grupi i auditimit ka konstatuar se, për sa i përket politikave të vazhdimësisë së punës dhe rikuperimit nga katastrofat, nga ana e AKSHI-t, në zbatim të përcaktimeve ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, është miratuar Udhëzimi nr.1 datë 31.07.2023 “Për Zbatimin e Dokumentit të Përditësuar të Politikave të Vazhdimësisë së Punës dhe Planit për Ruajtjen e Informacionit”.

Ky është një dokument politik i AKSHI-t dhe shërben si një udhëzues i cili përcakton veprimet dhe masat që duhet të merren për mbrojtjen e shërbimeve, sistemeve të teknologjisë së informacionit në pronësi dhe përdorim nga institucionet e administratës publike dhe të dhënave që administrohen përmes tyre, nga humbja apo shkatërrimi në rast të incidenteve apo fatkeqësive njerëzore, ambientale, natyrore, shoqërore dhe katastrofave apo krizave kombëtare. Në rast se evidentohet një incident apo fatkeqësi e cila ndikon dhe pamundëson AKSHI-n ose institucionet e tjera publike në Shqipëri për të ofruar shërbimet dhe operationet që baza ligjore dhe nënligjore në fuqi përcakton për këtë institucion, nga vendndodhja e tij, do të jenë strategjitë e *backup*-it dhe të tjera të rikuperimit të përcaktuara në këtë dokument, të cilat do të vihen në përdorim nga personeli dhe individët përgjegjës për të koordinuar rikuperimin në gjendje

normale të punës sipas detyrave të paracaktuara. Në këtë Udhëzues është parashikuar shprehimisht që zbatohet për të gjitha institucionet e administratës publike që kanë transferuar infrastrukturën dhe burimet IT tek AKSHI, sikurse dhe AKBPM.

Një aspekt tjetër lidhur me sigurinë e informacionit është edhe procesi i ndryshimeve dhe kontrolleve të tyre. Ky proces nevojitet për t'u siguruar nëse të gjitha konfigurimet e ndryshimeve të sistemeve janë të autorizuar, testuara, dokumentuara dhe kontrolluara në mënyrë që sistemet të vazhdojnë të mbështesin operacionet e institucionit sipas planit dhe në mënyrë që të gjitha gjurmët të dokumentohen. Një ndryshim i paaprovuar ose aksidental mund të ketë risqe të ndryshme dhe pasoja financiare për institucionin, sikurse përcakton dhe Standardi ISO 27001 dhe praktikat më të mira në fushën e sigurisë së informacionit.

AKSHI, si institucioni që mbikëqyr dhe rregullon proceset IT, si dhe AKBPM si përdorues i sistemit, nuk rezultojnë të kenë dokumentuar dhe miratuar ndryshimet që janë kryer në Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave (SIRKB) gjatë periudhës së audituar. Megjithëse procesi i punës ka vijuar dhe ndryshimet në sisteme kanë ndodhur çdo herë që ka rezultuar e nevojshme, nuk rezulton të ketë asnjë gjurmë për të dokumentuar, vlerësuar, prioritarizuar, testuar dhe rishikuar ndryshimet në këtë sistem dhe infrastrukturë.

➤ ***Mbi përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe të drejtat e tyre***

Nga auditimi u konstatua se subjekti, si AKBPM, ashtu edhe AKSHI, nuk kanë vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë listë të përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm të Sistemit të Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave (SIRKB), të drejtat e këtyre përdoruesve, si dhe akseset specifike që kanë në institucion. Kjo mungesë e informacionit sjell disa pasoja të rëndësishme si:

▪ **Devijim nga rregulloret dhe standardet**

Institucionet janë të detyruar të mbajnë regjistra të detajuar të përdoruesve dhe të të drejtave të tyre për të përmbushur kërkesat e rregulloreve dhe standardeve të sigurisë (si p.sh. ISO 27001 mbi sigurinë e informacionit).

▪ **Mungesë kontrolli mbi aksesin**

Në mungesë të një regjistri të përdoruesve dhe të të drejtave të tyre, është e pamundur të monitorohet dhe kontrollohet në mënyrë efektive se kush ka akses dhe në çfarë informacionesh në sisteme. Kjo mund të çojë në akses të paautorizuar dhe të papërshtatshëm në të dhëna sensitive.

▪ **Vështirësi në menaxhimin e sigurisë**

Pa një listë të përdoruesve, nuk mund të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e qarta për çdo përdorues. Kjo pengon zbatimin e politikave të sigurisë dhe procedurave të menaxhimit të risqeve.

▪ **Informacion të pasaktë**

Mungesa e një regjistri të përditësuar mund të rezultojë në mbajtjen e përdoruesve të cilët nuk janë më pjesë e institucionit, por që ende kanë akses në sistemet e saj. Kjo krijon një rrezik të madh për sigurinë e informacionit dhe mund të shfrytëzohet me keqdashje.

▪ **Risk për incidentet e sigurisë**

Në rast të një incidenti sigurie, pa një regjistër të qartë të përdoruesve, është e vështirë të përcaktohet origjina dhe shtrirja e incidentit. Kjo vonon përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga incidentet, duke rritur dëmin potencial.

▪ **Menaxhimi i aksesit në emergjencë**

Në situata emergjente, si një sulm kibernetik ose një gabim i rëndë sistemi, është e rëndësishme të dihet se kush ka akses dhe çfarë mund të bëjë për të reaguar shpejt dhe me efikasitet. Mungesa

e informacionit të saktë mbi përdoruesit dhe të drejtat e tyre e bën menaxhimin e emergjencave shumë më të vështirë.

Për arsyet e mësipërme, është thelbësore që AKSHI, në bashkëpunim me AKBPM, të krijojë dhe të mirëmbajë një regjistër të detajuar dhe të përditësuar të përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm të sistemit të tyre, si dhe të të drejtave dhe aksesit që ata kanë. Kjo do të ndihmojë në monitorimin dhe përmirësimin e sigurisë së informacionit, menaxhimin e risqeve dhe në përmbushjen e kërkesave të rregulloreve dhe standardeve të sigurisë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024:

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përdoruesve janë të parashikuara në rregulloren nr.02, datë 06.11.2023 "Për Sigurinë e Informacionit" ku paraqiten qartë elementët e ndarjes së privilegjeve dhe detyrate përdoruesve. Në vlerësimin tonë është më efektiv një rregullore gjithëpërfshirëse sesa përcaktimi i tyre rastpas rasti, duke marrë parasysh që punonjësit e institucioneve janë në lëvizje të vazhdueshme dhe një praktikë e tillë do të bënte të vështirë ndjekjen dhe përditësimin e akteve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Megjithë kërkesat e vazhdueshme për dokumentacionin e nevojshëm nga grupi i auditimit, rregullorja të cilës i referohet AKSHI, nuk është vënë në dispozicion në mënyrë që të vlerësojmë ndarjen e përgjegjësive dhe efektivitetin e një rregullore të përgjithshme për të gjitha institucionet. Nisur nga fakti që AKBPM nuk është në dijeni të përdoruesve që aksesojnë të dhënat e sistemit informatik (SIRKB), tregon se rregullorja e përgjithshme nuk ka patur zbatim konkret dhe efektivitet.

Për këtë arsye, grupi i auditimit gjykon që nevojitet të hartohen udhëzues specifikë për secilin institucion. Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i AKBPM dërguar me shkresën nr.1407/12, datë 28.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/5, datë 30.08.2024: "Implementimi dhe zbatimi i kontratës në nivel teknik ka qenë dhe vazhdon të jetë nën përgjegjësinë e AKSHI-t..

..mungesa e dokumentimit të veprimeve në sistem, qartazi nuk janë në fushën e përgjegjësisë së AKBPM-së".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi për menaxhimin e ndryshimeve i drejtohet AKSHI-t si AK dhe si institucioni përgjegjës dhe me burimet njerëzore me kapacitet për të kuptuar, ndërtuar dhe monitoruar modele të qendryeshme për menaxhimin e ndryshimeve që ndodhin gjatë mirëmbajtjes nga ofruesit e shërbimit. Gjatë testimeve në ndryshime që afektojnë sistemin SIRKB, nevojitet pjesëmarrja e AKBPM-ës, ndërsa kalimi i këtyre ndryshimeve në LIVE, AKBPM nuk disponon kapacitete njerëzore që të monitorojnë këtë proces.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: "…çdo ndryshim që aplikohet në sistem behet në përputhje me kontratën nr. 11 datë 08.06.2022 me objekt "Përmirësimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për AKBPM". Pjesë e grupit të punës për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate janë edhe dy antare të AKBPM. Si rrjedhim çdo veprim për ndryshime në sistem kryhet me konfirmimin e të gjithë ndjekësve dhe sidomos të ndjekësve të institucionit përfitues. Kjo dokumentohet edhe me miratimet e raporteve mujore të konfirmuara nga grupi i menaxhimit të kontratës dhe nga komunikimet zyrtare që kryhen për çdo ndryshim që kërkohej dhe realizohet në sistem. Pra nisur nga sa më sipër, masat që grupi i auditimit i ka lënë si

rekomandime per zbatim, jane elemente qe edhe ne te kaluaren dhe aktualisht jane te zbatuara dhe te realizuara ne çdo kohe”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Menaxhimi i ndryshimeve është kërkesë e Standardit ISO27001:2022, kontrolli 8.32 i cili pason dhe kontrole te tjera. Të drejtat dhe detyrimet e menaxhimit të ndryshimeve nuk mund të mbeten vetëm në mdjekjen dhe zbatimin e kontratës së mirëmbajtjes.

Për këtë arsye, grupi i auditimit në lidhje me këtë çështje mban qëndrimin që kërkesate standardit mund të plotësohen vetëm nga AKSHI.

Observacioni pranohet pjesërisht, duke hequr nga menaxhimi i ndryshimeve AKBPM pasi nuk disponon kapacitete njerëzore për të monitoruar procese të kësaj natyre.

2.2 Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit

a. *Investimet në drejtim të teknologjisë së informacionit dhe Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.*

Në zbatim të pikës 2 “Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit”, u shqyrtua zbatimi mbi marrëveshjen në nivel shërbimi kontraktuar nga AKSHI, si më poshtë:

Objekti	Kontrata, Data	Vlera e kontratës (pa TVSh)	Implementim (pa TVSh)	Mirëmbajtje (pa TVSh)	Afati
Përmirësimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për AKBPM	Nr. 11, 08.06.2022	134,330,780	98,238,100	36,092,680	4 muaj implementim
					24 muaj mirëmbajtje

Sistemi i informacionit të regjistrimit dhe kontrollit të barnave – SIRKB është prokuruar për herë të parë në vitin 2014 nga Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Organit Qëndror Blerës, ku Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave ka qenë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor për kontratën me nr.4059/2 prot., datë 8.7.2014.

Në vitin 2022 është zhvilluar procedura e prokurimit nga AKSHI me objekt “Përmirësimi i sistemit të barnave dhe pajisjeve mjekësore për AKBPM”, për të cilin është nënshkruar me BOE të shpallur fitues dhe kontrata me nr.11, datë 08.06.202, nga AKSHI si Autoritet Kontraktor. Dokumentacioni për zhvillimin e procedurës së prokurimit gjendet tek AKSHI dhe nuk është objekt i këtij auditimi.

Kontrata nr.11, datë 08.06.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për AKBPM”, është amenduar për shtyrjen e afatit të implementimit nisur nga shkaqe që nuk varen nga OE por nga prodhuesi dhe me shkresën nr.6502 prot, datë 18.10.2022 është vënë në dijeni AKBPM për amendimin e kontratës në lidhje me afatin e saj i cili është përcaktuar nga AKSHI si Autoriteti Kontraktor, që të jetë 23.12.2022.

Vlera e kontratës për ndërtimin e këtij sistemi dhe mirëmbajtjen e tij është 134,330,780 lekë pa TVSH, ku vlera e implementimit është 98,238,100 lekë, ndërsa vlera e mirëmbajtjes është 36,092,680 lekë ose 36.7% e vlerës së implementimit. Afati i implementimit të përmirësimit të këtij sistemi nga 4 muaj është amenduar deri në datën 23.12.2024. Mirëmbajtja ka filluar me përfundimin e fazës së implementimit të sistemit të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe infrastrukturës së re dhe do të vijojë për një periudhë 24 mujore. Pagesat për këtë kontratë përgjatë periudhës objekt auditimi, janë kryer nga AKBPM.

Qëllimi i këtij projekti ka qenë përmirësimi i sistemit informatik të regjistrimit të kontrollit të barnave, duke shtuar regjistrin elektronik të pajisjeve mjekësore si dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike.

AKBPM me shkresën nr.3227/25 prot., datë 23.02.2023, ka përcjellë tek AKSHI kërkesën për transferimin kapital të pajisjeve të sistemit të regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Lista e aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara të sistemit SIRKB përmban elementët si mëposhtë:

Nr	Përshkrimi	Tipi	Sasia	Vlera pa TVSh
1	Përmirësimi i sistemit të regjistrimit të kontrollit të barnave	Software	1	40,197,300
2	Implementimi ne DIS për ndërveprim me platformen qeveritare të ndërveprimit dhe ndërtimi i shërbimeve elektronike në portalin qeveritar e-Albania	Software	1	41,602,800
3	Server HP Proliant DL360 Gen10	Hardware	2	3,626,000
4	Storage HPE MSA 2060 SAN Storage Array	Hardware	1	3,342,000
5	Switch Gigabyte Ethernet Cisco Catalyst 9300 Series Switches	Hardware	2	1,790,000
6	Firewall FortiGate 200F	Hardware	2	4,140,000
7	Load Balancer Kemp Load Master Hardware	Hardware	1	1,100,000
8	Instalim konfigurime për realizimin e projektit		1	2,250,000
9	Totali i projektit			117,657,720
10	Trajnim për sistemin (5 punonjës)		1	228,000
11	Vlera e Implementimit			117,885,720

Zëri “Trajnim për sistemin (5 punonjës)”, që nuk është i regjistruar si aset por shpenzim, nuk është pjesë e transferimit të këtij investimi tek AKSHI.

Nga auditimi u konstatua se, AKSHI nuk ka kthyer asnjë përgjigje me kopjen e faturës së hyrjes në përgjigje të shkresës për transferim.

Raportet periodike të mirëmbajtjes për periudhën objekt auditimi, sipas kontratës nr.11, datë 08.06.2022 i përkasin periudhës dhjetor 2022 – dhjetor 2023.

Ndjekësit e kontratës janë përcaktuar në urdhrin e AKSHI-t nr.11/1, datë 08.06.2022 janë:

- z. A. Th. – Përfaqësues nga AKSHI;
- z. S. H. – Përfaqësues nga AKSHI;
- znj. H. H. – Përfaqësues nga AKBPM;
- znj. O. K. – Përfaqësues nga AKBPM.

Ndjekësit e kontratës kanë ndryshuar me urdhrin e AKSHI-t nr.11/14, datë 10.07.2023:

- z. L. G. – Përfaqësues nga AKSHI;
- z. S. H. – Përfaqësues nga AKSHI;
- znj. H. H. – Përfaqësues nga AKBPM;

- znj. O. K. – Përfaqësues nga AKBPM.

Ndjekësit e kontratës janë ndryshuar dhe me urdhrin e AKSHI-t nr.11/25, datë 27.02.2024:

- z. K. M. – Përfaqësues nga AKSHI;
- z. F. L. – Përfaqësues nga AKSHI;
- znj. H. H. – Përfaqësues nga AKBPM;
- znj. O. K. – Përfaqësues nga AKBPM.

Ndjekësit e kontratës që kanë ndryshuar në të gjitha rastet janë punonjësit e AKSHI-t, ndërsa përfaqësuesit nga AKBPM janë të njëjtët punonjës të përcaktuar që prej fillimit të kontratës. Urdhri i përcaktimit të ndjekësve të kontratës i ngarkuar në sistemin SMK, është nënshkruar vetëm nga titullari i AKSHI-t, ndërsa AKBPM e ka bërë me dije në rrugë shkresore Autoritetin Kontraktor, për punonjësit e caktuar si ndjekës të kontratës përfaqësues të këtij institucioni.

Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar në sistemin e SMK plani i zbatimit të kontratës me nr.11, datë 08.06.2022 “Përmirësimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për AKBPM”, në kundërshtim me:

- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin2/pika L, i ndryshuar;
- Udhëzimin nr.2, datë 18.03.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi Raportimin e Zbatimit të Kontratës dhe formularit për zbatimin e kontratës.

Mungesa e këtij dokumenti jo vetëm që është në kundërshtim me kriteret ligjore përmendur më sipër, por pengon procesin e monitorimit sipas treguesve specifike të monitorimit të kontratës. Me rekomandimin nr.6858, datë 07.10.2022 mbi mënyrën e hartimit të formularëve të zbatimit të kontratës, APP rekomandon hartimin e planit të zbatimit të kontratës nga personat përgjegjës për ndjekjen e saj të caktuar nga Autoriteti Kontraktor. Ky dokument që nënshkruhet nga AK dhe Operatori Ekonomik, i plotësuar sipas udhëzimeve përkatëse i shërben të gjithë palëve për të monitoruar nëse kontrata përmbushet në vlerën, kohën, sasinë dhe cilësinë sipas kushteve të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Faza e implementimit është dokumentuar në sistemin e menaxhimit të kontratave si më poshtë:

- Me shkresën nr.11/2 prot, datë 13.06.2022 në sistemin SMK është ngarkuar dhe nënshkruar nga përfaqësuesit e BOE raporti fillestar kërkuar në specifikimet teknike.
- Me shkresën nr.11/3 prot, datë 1.11.2022 në sistemin SMK janë ngarkuar dhe nënshkruar aktmarrja në dorëzim, testimi i pranimit, raporti i implementimit si dhe fatura për shërbimet e kryera që janë:
 - Përmirësimi i sistemit të regjistrimit të kontrollit të barnave;
 - Implementimi në DIS për ndërveprimin me platformën qeveritare të ndërveprimit dhe ndërtimi i shërbimeve elektronike në portalin qeveritar e-albania.
- Me shkresën nr.11/4 prot, datë 23.11.2022 në sistemin SMK është ngarkuar dhe nënshkruar Draft raporti përfundimtar.
- Me shkresën nr.11/5 prot, datë 25.11.2022 në sistemin SMK janë ngarkuar nga BOE dokumentet e mbajtuara për aktmarrjen në dorëzim si dhe garancitë për pajisjet:
 - Server –2 copë;
 - Storage – 1 copë;
 - Firewall - 2 copë;
 - Load Balancer – 1 copë.

Dokumentacioni është nënshkruar nga të gjithë ndjekësit e kontratës në datë 07.12.2022.

- Me shkresën nr.11/6 prot, datë 01.12.2022 është përcjellë nga BOE në sistemin SMK aktmarrja në dorëzim për 2 switch.

- Me shkresën nr.11/7 prot, datë 22.12.2022 është përcjellë nga BOE në sistemin SMK, Raporti përfundimtar dhe dokumentacioni teknik, trajnimet e zhvilluara për përdoruesit e sistemit si dhe faturat përkatëse.

Për fazën e implementimit janë aprovuar urdhër shpenzimet sipas tabelës së mëposhtme:

Urdhër Shpenzim	Llogaria ekonomike	Data	Vlera me TVSh
148	231	04.11.2022	98,160,120
185	231	19.12.2022	14,649,600
186	231	19.12.2022	2,148,000
193	231	28.12.2022	2,062,515
194	602	28.12.2022	228,000
196	231	30.12.2022	637,485
Totali			117,875,720

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për fazën e implementimit, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 117,885,720 lekë me TVSh.

AKBPM nuk disponon ambient për pajisjet server. Pajisjet fizike që janë pjesë e kësaj kontrate, janë montuar dhe konfiguruar tek DataCenter që administrohet nga AKSHI.

Në dokumentacionin e mbajtur nga ndjekësit e kontratës përgjatë periudhës dhjetor 2022 - dhjetor 2023, faza e mirëmbajtjes është dokumentuar si më poshtë:

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.12.2022 – 23.01.2023, dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr.11/8 prot, datë 23.01.2023, është nënshkruar në datën 15.02.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për mirëmbajtjen në këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar si dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. urdhër shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
19	28.02.2023	92/2023	23.01.2023	288,741	24.12.2022 – 23.01.2023
20	28.02.2023	4/2023	23.01.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.01.2023 – 23.02.2023, dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr.11/9 prot, datë 24.02.2023, është nënshkruar nga anëtar i fundit në datën 09.03.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
54	13.04.2023	326/2023	24.02.2023	288,741	24.01.2023 – 23.02.2023
55	13.04.2023	9/2023	24.02.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.02.2023 – 23.03.2023, dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr.11/10 prot, datë 24.03.2023, është nënshkruar nga anëtar i fundit në datën 18.04.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
60	27.04.2023	568/2023	24.03.2023	288,741	24.02.2023 – 23.03.2023
61	27.04.2023	13/2023	24.03.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.03.2023 – 23.04.2023, dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr.11/11 prot, datë 24.04.2023, është nënshkruar nga anëtar i fundit në datën 25.05.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
81	05.06.2023	771/2023	24.04.2023	288,741	24.03.2023 – 23.04.2023
82	05.06.2023	20/2023	24.04.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 23.04.2023 – 24.05.2023, dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr.11/12 prot, datë 24.05.2023, është nënshkruar nga anëtar i fundit në datën 26.06.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
97	11.07.2023	1031/2023	24.05.2023	288,741	

98	11.07.2023	23/2023	24.05.2023	1,515,892	24.04.2023 – 23.05.2023
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 23.05.2023 – 24.06.2023, dokumentacioni justifikues i mirëmbajtjes është percjellë me shkresën nr.11/13 prot, datë 26.06.2023 dhe nënshkruar elektronikisht nga 3 ndjekësit e kontratës ku data e nënshkrimit të fundit është 07.08.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës. Ky dokumentacion nuk është nënshkruar elektronikisht nga një ndjekës kontrate që është përfaqësues i AKSHI-t, i cili është zëvendësuar me një tjetër punonjës me urdhrin nr.11/14, datë 10.07.2023.

Me shkresën nr.3227/36 prot., datë 09.10.2023, sektori i financës në AKBPM ka dokumentuar arsyet që pagesa nuk është kryer për shkak se mungon nënshkrimi i një prej ndjekësve të kontratës. Për këtë sektori i financës i është drejtuar dhe AKSHI-t në cilësinë e Autoriteti Kontraktor nëpërmjet postës elektronike.

Sektori i çështjeve juridike në AKBPM, ka analizuar dhe vlerësuar se bazuar në kushtet aktuale të kontratës si dhe mungesës së një përgjigje nga AKSHI në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka vlerësuar se nuk ka një shkak ligjor për moskryerjen e pagesës së shërbimit të mirëmbajtjes të marrë në periudhën 23.05.2023-24.06.2023 dhe faturuar në datën 26.06.2023.

Nga auditimi u konstatua se AKBPM nuk ka kryer pagesën e shërbimit të mirëmbajtjes për periudhën 23.05.2023 – 24.06.2023, për arsye se mungon nënshkrimi elektronik i një prej ndjekësve të kontratës, kur 3 anëtarët e tjerë e kanë nënshkruar marrjen e këtij shërbimi. Pas afërsisht 16 ditësh kalendrike është ndryshuar ndjekësi i kontratës dhe nënshkrimi në sistem nuk është kryer nga anëtari i larguar dhe as nga anëtari i ri i caktuar, çfarë tregon për mungesë të administrimit të proceseve të punës për punonjësit që largohen dhe ndjekjen e detyrave të lëna pezull nga ndjekësit e caktuar rishtaz për monitorimin dhe ndjekjen e kontratës nga ana e AKSHI-t.

Në nenin 10, pika 1 thuhet se *“Në përfundim të çdo lëvrimi shërbimi/pune/mallra (pajisje hardware), por jo më vonë se 3 ditë pune nga data e çdo lëvrimi, përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor (përcaktuar në Nenin 3.2 KVK) do të kryejnë pranimin e shërbimeve/punëve/mallrave të kryera dhe dorëzuar nga Kontraktuesi duke plotësuar hapat”* e përcaktuar në kapitullin “Kushtet e veçanta të kontratës - Shërbimet”.

Për sa më sipër, grupi i auditimit është i mendimit se ndjekja e rrugës gjyqësore nga ana e BOE për mos kryerje të pagesës, mund të ekspozojë AKBPM ndaj kostove shtesë, pasi nuk ka asnjë gjurmë teknike se nuk janë realizuar shërbimet e kontroleve periodike nga ndjekësit e kontratës që kanë nënshkruar, brenda 3 ditëve sic parashikohet në kontratë apo dhe pas kalimit të këtij afati.

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.06.2023 – 23.07.2023, dokumentacioni i percjellë me shkresën nr.11/15 prot, datë 24.07.2023, është nënshkruar nga anëtari i fundit në datën 31.08.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
123	13.09.2023	1456/2023	24.07.2023	288,741	

124	13.09.2023	34/2023	24.04.2023	1,515,892	24.06.2023 – 23.07.2023
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.07.2022 – 23.08.2023, dokumentacioni i percjellë me shkresën nr.11/16 prot, datë 24.08.2023, është nënshkruar nga anëtari i fundit në datën 27.10.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
184	11.12.2023	1686/2023	24.08.2023	288,741	24.07.2023 – 23.08.2023
185	11.12.2023	37/2023	24.08.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.08.2023 – 23.09.2023, dokumentacioni i percjellë me shkresën nr.11/17 prot, datë 25.09.2023, është nënshkruar nga anëtari i fundit në datën 16.10.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
148	30.10.2023	1899/2023	25.09.2023	288,741	24.08.2023 – 23.09.2023
149	30.10.2023	42/2023	25.09.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

Megjithëse ky faturim është kryer në muajin shtator, pagesa e tij është bërë më përpara se faturimi i kryer në muajin gusht.

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.09.2023 – 23.10.2023, dokumentacioni i percjellë me shkresën nr.11/18 prot, datë 24.08.2023, është nënshkruar nga anëtari i fundit në datën 27.10.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
188	14.12.2023	2124/2023	24.10.2023	288,741	24.09.2023 – 23.10.2023
189	14.12.2023	49/2023	24.10.2023	1,515,892	

Totali				1,804,633	
--------	--	--	--	-----------	--

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.10.2023 – 23.11.2023, dokumentacioni i percjellë me shkresën nr.11/19 prot, datë 24.11.2023, është nënshkruar nga anëtari i fundit në datën 26.12.2023, pra afërsisht 1 muaj më vonë. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
193	28.12.2023	2356/2023	24.11.2023	288,741	24.10.2023 – 23.11.2023
194	29.12.2023	58/2023	24.11.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

- Për mirëmbajtjen që përkon me periudhën 24.11.2023 – 23.12.2023, dokumentacioni i percjellë me shkresën nr.11/20 prot, datë 26.12.2023, është nënshkruar nga anëtari i fundit në datën 28.12.2023. Dokumentet e ngarkuar në sistem janë Raporti mujor i mirëmbajtjes, faturat specifike të shërbimit të ofruar nga secili subjekt i bashkimit të operatorëve si dhe Procesverbali i grupit të ndjekjes së kontratës.

Totali i vlerës së urdhër shpenzimeve për këtë periudhë, përkon me vlerën e faturuar dhe atë të planifikuar në kontratë që është 1,804,633 me TVSh.

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr.Fatura	Data faturës	Vlera me TVSh	Periudha e Mirëmbajtjes
195	29.12.2023	2629/2023	26.12.2023	288,741	24.11.2023 – 23.12.2023
196	29.12.2023	66/2023	26.12.2023	1,515,892	
Totali				1,804,633	

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës dhe dokumentacionin e mbajtur për shërbimin e mirëmbajtjes, u konstatua se:

- Në asnjë rast nuk është respektuar afati 3 ditor përcaktuar në kushtet e vecanta neni 10/pika 10.1, të kontratës nr.11, datë 08.06.2022, ku në disa raste shërbimi i mirëmbajtjes është marrë në dorëzim pas më shumë se 1 muaj.

- Raportimet apo komunikimet e ndryshme realizohen jashtë sistemit të menaxhimit të kontratave me email ose telefon, duke e bërë të pagjurmueshëm kohën dhe cilësinë mbi zgjidhjen e problemit të raportuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKBPM dërguar me shkresën nr.1407/12, datë 28.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/5, datë 30.08.2024: “Në zbatim të Ligjit Mr.162/2020 ‘Për prokurimin publik’ të ndryshuar, neni 120 e në vijim, të VKM Nr.285/2021 të ndryshuar, neni 107, hartimi i planit të zbatimit të kontratës apo dërgimi në SMK është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktor dhe nuk mund t’i ngarkohet Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve

Mjekësore, e cila në zbatim të Kontratën Nr.11, datë 8.6.2022 me objekt “ Përmirësimi i Sistemit të Barna dhe Pajisjeve Mjekësore” gezon statusin e ‘Përfituesit të Shërbimit’.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Plani i zbatimit të kontratës nevojitet të jetë në sistemin e menaxhimit të kontratave, në dispozicion të grupit ndjekës të kontratës të caktuar në bashkpunim me AKBPM, por nuk është përcaktuar si përgjegjësi e AKBPM-ës.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “Na lejoni te informojme grupin e auditimit se ne vijim te ndryshimeve te legjislacionit ne fuqi ky rekomandim eshte pare dhe reflektuar nga AKSHI. Ne kontratat e reja te lidhura pas vitit 2022 eshte bere rishikimi i afateve te rekomanduara nga grupi auditimit.

Ndërsa ne lidhje me piken e dyte AKSHI ka vendosur ne dispozicion Sistemin e Menaxhimit te Kontratave dhe grupi i ngritur per menaxhimin e kontrates mund te aprovoje apo ktheje per korrigjim raportet mujore ne raste te evidentimit te problematikave qe afektojne kontraten. Pra nisur nga sa me siper, masat qe grupi i auditimit i ka lene si rekomandime per zbatim, jane elemente qe edhe ne te kaluaren dhe aktualisht jane te zbatuara dhe te realizuara ne çdo kohe”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pika e parë e rekomanduar për afatin 3 ditor për marrjen në dorëzim do të verifikohet në zbatimin e rekomandimeve nga KLSH.

Ndërsa për pikën e dytë sqarojmë se sistemi i menaxhimit të kontratave nuk ofron mundësinë ku ndjekësit e kontratës nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Përfitues si dhe Operatorit Ekonomik, të mund të adresojnë problematikën që dalin gjatë ndjekjes së kontratës, por vetëm kthimin ose aprovimin e dokumentacionit në fund të periudhës për çdo mirëmbajtje. Për sa më sipër, ky observacion nuk merret në konsideratë.

2.3 Auditimi i sistemit informatik mbi të dhënat Input/Output

Në zbatim të pikës 3, është shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemi informatik i Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore mbi të dhënat Input/Output si dhe dokumentacioni udhëzues i nevojshëm, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij, si:

- Manualët e përdorimit;
- Shërbimet e kontraktuara në përmirësimin dhe mirëmbajtjen me kontratën nr.11 prot, datë 08.06.2022;
- Ndërveprimet me sisteme të tjera;
- Diagrama të funksionimit të sistemit;
- Rregullore mbi përdorimin e sistemit dhe ndarjen e funksionaliteteve,
- Manual përdorimi mbi krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve, etj.

Në vitin 2022 është zhvilluar procedura e prokurimit nga AKSHI me objekt “Përmirësimi i sistemit të barnave dhe pajisjeve mjekësore për AKBPM”, për të cilin është nënshkruar dhe kontrata me nr.11, datë 08.06.2022, ndërmjet AKSHI-t si AK dhe BOE të shpallur fitues. Procedura e prokurimit nuk është objekt i këtij auditimi.

Qëllimi i këtij projekti investimi ka qenë përmirësimi i sistemit informatik të regjistrimit të kontrollit të barnave duke shtuar regjistrin elektronik të pajisjeve mjekësore si dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike.

Nga auditimi mbi dokumentacionin udhëzues për ndërtimin dhe funksionimin e sistemit, u konstatua se:

- Nuk ka një dokumentim për manualin e sistemit, për përdoruesit e brendshëm që janë punonjës të AKBPM;

- Kriteret e aplikuara në sistem për fjalëkalimin e përdoruesve janë minimaliste. Nga testimet rezultoi se fjalëkalimi kërkon minimumi 5 karaktere dhe nuk janë aplikuar kritere për përmbajtjen dhe vlefshmërinë;
- Nuk janë përcaktuar të drejtat administrative të të dhënave të këtij sistemi, ndërkohë që AKSHI pretendon se siguron vetëm administrimin nga ana teknike të çdo sistemi TIK dhe AKBPM nuk ka asnjë strukturë të dedikuar për administrimin e të dhënave në sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore;
- Nuk ka një gjurmë dokumentimi mbi aksesin që i është dhënë dhe i jepet në vazhdimësi OE që ka zhvilluar dhe aktualisht mirëmban sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “Në lidhje me rekomandimin nr.8.1, ju bëjmë me dije se manualet e përdorimit janë vendosur në dispozicion të ndjekësve të kontratës, duke përfshirë këtu edhe ndjekësit e institucionit përfitues, AKBPM si gjatë trajnimeve të përdoruesve, ashtu edhe gjatë suportit onsite që operatori ka ofruar në përfundim të implementimit të përmirësimit të sistemit. Gjithashtu në sistemin e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në panelin e menaxhimit të përdoruesve ekzistojnë edhe opsionet e menaxhimit të politikave të kompleksitetit të fjalëkalimeve ku përfshihet edhe gjatesia e fjalëkalimit, rregullat e fjalëkalimit dhe limiti i tentativave të logimit të pasuksesshem paste cilit përdoruesi bëhet disabled. Bashkelidhur gjëni screenshot të panelit të menaxhimit dhe të gjithë kontrollat kanë qenë dhe vijojnë të jenë të aplikuara në përputhje me bazën rregullatore në fuqi. Pra nisur nga sa me sipër rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit është element që dhe në të kaluarën dhe aktualisht kanë qenë dhe janë të aplikuara”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ju bëjmë me dije se manuali i përdorimit vendosur në dispozicion nuk është manuali i përdoruesve punonjës të AKBPM-ës. Screen që keni dërguar nuk tregon për asnjë detaj mbi kompleksitetin dhe karakteristikat e logimit, e në këto kushte ky rekomandim do të mbetet në fuqi dhe do të verifikohet në fazën e zbatimit të tij. Observacion për këtë çështje nuk merret në konsideratë.

Bazuar në informacionin e marrë nga struktura e IT në Ministrinë e Shëndetësisë, për sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore nuk është bërë një regjistrim si një bazë të dhënash shtetërore.

Në mungesë të informacionit si dhe dokumentacionit si detyrim i regjistrimit të bazës së të dhënave shtetërore, u audituan të dhënat që janë input dhe që regjistrohen për herë të parë nga AKBPM.

Nga auditimi mbi të dhënat që plotësohen në sistem konstatohet se ky institucion disponon të dhëna parësore, që gjenerohen në përdorimin e sistemit të regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore në AKBPM, që janë:

- Seria e Barit;
- Numri Serial i Pullës;
- Emri i Barit;
- Çmimi i importit për çdo bar dhe çdo paketim;
- Çmimi i pullës që është çmimi i shitjes;
- Prodhuesi, etj.

Të dhënat dytësore janë gjithë të dhënat e tjera që i nevojiten plotësisë së informacionit dhe aktivitetit të agjencisë, me të cilat janë ndërtuar dhe ndërveprime.

Nga auditimi u konstatua se nuk ka një akt krijimi të bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, që do të thotë se nuk është bërë një identifikim i të dhënave parësore të këtij sistemi si dhe të dhënat dytësore që nevojiten për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij. Për këtë bazë të dhënash, nuk janë përcaktuar rregullat për krijimin dhe administrimin si një bazë të dhënash, sipas nenit 4 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, që janë:

- a) institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore;
- b) të dhënat parësore dhe dytësore;
- c) dhënësin/dhënësit e informacionit;
- ç) ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;
- d) nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.

Infrastruktura Software dhe Hardware ku është ngritur Sistemi i Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave, deri në fund të vitit 2022 ka qenë e konsideruar Infrastrukturë Kritike e informacionit, bazuar në VKM nr. 553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, që i përket periudhës objekt auditimi. Me hyrjen në fuqi të ndryshime me VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.553, datë 15.7.2020, të këshillit të ministrave, “për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, sistemi tashmë i përmirësuar me emrin “Sistemi i Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, nuk rezulton të jetë në listën e infrastrukturave kritike apo të rëndësishme të informacionit, megjithëse rëndësia e tij është e lartë nisur nga fakti që cenimi apo shkatërrimi i tij do të kishte impakt serioz në shëndetin e qytetarëve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “...na lejoni t’ju bejme me dije se lidhur me kete rekomandim te grupit te auditimit, se bazuar ne ligjin 25/2024 "Per Sigurine Kibernetike", konkretisht neni 12 "Identifikimi i infrastrukturave kritike dhe te rendesishme te informacionit, pika I, cilesohet se Autoriteti kryen identifikimin e infrastrukturave kritike dhe te rendesishme te informacionit ne vazhdimesi ne bashkepunim dhe ne bashkerendim me subjektet e tjera pergjegjese per sigurine kibernetike ". Pra autoriteti pergjegjes per identifikimin eshte Autoriteti Kombetar per Sigurine Kibernetike, si rrjedhoje inicimi i procesit sipas baze ligjore ne fuqi nuk realizohet nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit, por AKSHI eshte i gatshem te bashkerendoje ne çdo kohe me AKSK per procesin”.

Pretendimi i AKBPM dërguar me shkresën nr.1407/12, datë 28.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/5, datë 30.08.2024: “..e gjejmë me vend të theksojmë se iniciativën ligjore për rishikimin e listës e ka Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe e kushtëzuar me fushën e ekspertizës në çështjet e sigurisë së informacionit mbi bazën e të eilit bëhet dhe argumentimi në nivel teknik”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i drejtohet AKBPM dhe AKSHI-t si institucionet që njohin rëndësinë e sistemit dhe infrastrukturës ku gjendet sistemi SIRKB, të përcjellin tek AKSK propozimin për riklasifikimin e infrastrukturës në kritike. Do të jetë AKSK institucioni që do të iniciojë ndryshimet ligjore përkatëse. Nëse AKSK nuk informohet mbi

kritikalitetin e infrastrukturës nuk mund të iniciohet një ndryshim i tillë ligjor. Për këtë arsye observacionet nuk merren në konsideratë dhe rekomandimi mbetet i njëjtë.

Në pikën 7 të DST është përcaktuar se për këtë sistem do të ndërtohen ndërveprime me sisteme të tjera që janë:

- Sistemi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile;
- Sistemi i Qendrës Kombëtare të Biznesit;
- Sistemi i Recetës Elektronike për shpërndarjen e pajisjeve mjekësore (aty ku aplikohet);
- Portali qeveritar e_Albania;
- Rregjistri i Barnave të Rimbursueshme;
- Sistemi e_depo.

Nga auditimi u konstatua se AKSHI me kërkesat e specifikimeve teknike, për përmirësimin e sistemit të regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, ka kërkuar dhe ndërtuar ndërveprime me 6 sisteme të tjera, ku pjesa më e madhe njihen si baza të dhënash shtetërore. Këto ndërveprime të kërkuara dhe të ndërtuara mbi sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, janë në kundërshtim me VKM nr.945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, neni 9/pika 5, ku citohet se: “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore.”

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “...nuk është detyrim dhe përgjegjësi e AKSHI krijimi i aktit ligjor për krijimin e kësaj baze të dhënash shtetërore. Gjithsesi AKSHI mbetet në dispozicion për të mbështetur dhe ndihmuar AKBPM gjatë këtij procesi kurdo që ai të iniciohet, në zbatim të legjislativës në fuqi”.

Pretendimi i AKBPM dërguar me shkresën nr.1407/12, datë 28.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/5, datë 30.08.2024: Për sa kohë rezultoni e provuar në dokumente shkresore që AKBPM ka siguruar mbështetjen e nevojshme në lidhje me anën funksionale dhe ëorkflore të sistemit në përputhje me bazën ligjore të AKBPM sikurse është kërkuar nga AKSHI që në prill të vitit 2020, është natyrshëm angazhimi në këtë proces sapo të kërkohej nga AKSHI.

Qëndrimi i grupit të auditimit: AKBPM nuk disponon burime njerëzore që të udhëheqë procesin e dokumentimit të bazës së të dhënave shtetërore për sistemin SIRKB. Gjithashtu, nuk disponon informacion mbi ndërveprimet që janë ndërtuar me këtë sistem, informacion i cili disponohet nga AKSHI. Regjistrimi për bazën e të dhënave nuk mund të presë deri në plotësimin e vendit vakant të specialistit IT që mungon për AKBPM-en. Duke qenë se AKBPM është e gatshme të japë kontributin e saj për atë që mund të kuptojë nga ky dokumentim, nevojitet që AKSHI të marrë masa për ngarkimin e kësaj detyre tek një strukturë që mund të suportojë procesin e dokumentimit të bazës së të dhënave, atë më tepër kur ndërveprimet janë krijuar në kundërshtim me kundërshtim me VKM nr.945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, neni 9/pika 5, ku citohet se: “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore.”

Ky observacion nuk merret në konsideratë dhe rekomandimi do të mbetet i njëjtë, nisur për nga rëndësia që ka regjistrimi i bazës së të dhënave.

Shërbimet Online që ofrohen nëpërmjet portalit e-Albania:

- Aplikim për autorizim importi për barnat e pajisura me Autorizim për Tregtim në RSH. Për barnat narkotike autorizimi jepet nga MSHMS;
- Aplikim për autorizim importi/zhdoganim për lëndët aktive, ndihmëse dhe ambalazhe kryhet në e_albania dhe ngarkohet tek SQDNE. Për këtë është kërkuar zhvillimi nga OE që ofron mirëmbajtjen dhe aktualisht ky proces është në fazë testimi për tu vendosur në funksion në sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore.
- Aplikim për autorizim importi/zhdoganim për produktet alergene, është shërbim i ofruar nga AKBPM në gusht të vitit 2023 dhe aktualisht është në fazë testimi për tu vendosur në funksion në sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, pasi deri në këtë moment është proceduar në rrugë shkresore.
- Aplikim për autorizim zhdoganimi për barnat e pajisura me autorizim importi dhe për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope të pajisura me autorizim importi nga MSHMS dhe për barnat e paautorizuara;
- Aplikim për regjistrim pajisje mjekësore;
- Aplikim për ndryshim regjistrimi pajisje mjekësore;
- Autodeklarimi i importit për pajisje mjekësore;

Nga verifikimi në eAlbania, rezultoi se shërbimet e mësipërme online janë ndërtuar dhe janë funksionale.

Nga auditimi mbi dokumentet model për Autorizim Importi për lëndët aktive, ndihmëse dhe ambalazhe, Autorizim Zhdoganimi për lëndët aktive, ndihmëse dhe ambalazhe, u konstatua se janë dokumente që gjenerohen pa vulë dixhitale, por vetëm me nënshkrim elektronik.

Kontrollet mbi veprimet që hidhen në sistem kryhen elektronikisht, duke ndjekur hapa specifike deri tek niveli më i lartë drejtues i agjencisë, që në disa raste shoqërohen me dokument zyrtar aprovimi që i vihet në dispozicion subjektit që ka aplikuar.

Nga auditimi u konstatua se në ndërveprimet e sistemeve nuk është parashikuar ndërveprimi me sistemin doganor, ku:

- Autorizimi për import që aprovon AKBPM i dërgohet subjektit në llogarinë e tij në e-albania, dokument të cilin vetë subjekti e paraqet gjatë procesit të zhdoganimit;
- Deklarata Doganore i jepet subjektit në zhdoganim, një dokument të cilin subjekti ja paraqet inspektorëve të AKBPM në aktet e inspektimit.
- Certifikatë regjistrimi si dokument që shërben për importimin e pajisjeve mjekësore.

Komunikimi i munguar ndërmjet sistemit të doganave dhe atij të barnave dhe pajisjeve mjekësore, bën që të jetë subjekti në të dy rastet ai që dorëzon dokumentin në doganë mbi autorizimin e marrë nga AKBPM dhe dokumentin e zhdoganimit tek inspektorët e AKBPM, çfarë përbën një risk në ndryshimin e të dhënave dhe pamundësinë për të vërtetuar ndryshimet në përmbajtjen e tyre.

Nga auditimi u konstatua se në ndërveprimet e sistemeve nuk është parashikuar ndërveprimi me sistemin e MSHMS për autorizimi për import të barnave narkotike, lëndët psikotrope dhe barnat e peregjistruara, AKBPM vepron me autorizimin e zhdoganimit. Aktualisht ky komunikim mundësohet nëpërmjet subjektit, i cili dokumentin e marrë nga MSHMS nëpërmjet eAlbanias, e angarkon po në eAlbania në aplikimin që kryen për autorizim zhdoganimi në AKBPM, çfarë përbën një risk në ndryshimin e të dhënave dhe pamundësinë për të vërtetuar ndryshimet në përmbajtjen e tyre.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “Në lidhje me rekomandimin nr. 9.1, na lejoni te bejme me dije grupin e auditimit se ne kuader te procesit te riinxhinierizimit te sherbimeve online qe institucionet ofrojne ne portalin e-Albania, qe ka nisur ne bashkepunim me insitucionet sherbim ofruese dhe Agjencine per Dialog dhe Bashkeqeverisje, se nderveprimi me Sistemin Doganor per manjen e te dhenave te deklarates doganore ka qene nje prej sugjerimeve te bera nga AKSHI gjate takimeve konsultuese. Nga ana jone i jemi drejtuar me nje komunikim zylltar AKBPM per percaktimin e fushave te nevojshme per tu perfshire ne nderveprin,, pas konfirmimit te marre nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave. Me percjelljen e fushave nga AKBPM, do te vijohet me vleresimet dhe zhvillimet e nevojshme teknike. Bashkelidhur po vendosim komunikimet me email te mbajtura me palet”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim do të mbetet në fuqi dhe meqenëse procesi është iniciuar, do të verifikohet në fazën e zbatimit të rekomandimeve.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “Në lidhje me rekomandimin nr. 10.1, Na lejoni te bejme me dije se aktualisht Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka nje sistem backend te dedikuar per pritjen dhe trajtimin e aplikimeve per autorizimet e importit te barnave narkotike, lendeve psikotrope dhe barnave te paregjistruara ne Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale. Keto aplikime priten dhe trajtohen ne sistemin AMS, i cili eshte nje sistem prites i aplikimeve qe nuk kane nje backend te dedikuar i vene ne dispozicion nga AKSHI dhe nuk eshte sistem i dedikuar per MSHMS. Gjithashtu MSHMS dhe AKBPM ne zbatim te VKM Nr. 43, date 15.1.2020 "Per funksionimin e procesit te shkembimit te dokumenteve ndermjet institucioneve, nepermjet sistemit te qarkullimit te dokumenteve me nenshkrim elektronik", SQDNE, jane te pajisur me akses ne kete sistem per shkembimin e informacionit me nenshkrim elektronik, te nevojshem per trajtimin e aplikimeve”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në mungesë të një sistemi, sugjerojmë të aplikohen mënyra të tjera që lehtësojnë punën e shkëmbimit të informacionit që nevojitet të importohet në sistemin SIRKB për të minimizuar veprime manuale të përdoruesve dhe gabimet në këto veprime. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Ministria e Shëndetësisë, në fillim të çdo viti miraton listën e barnave dhe cmimet CIF, e cila dërgohet vetëm nëpërmjet komunikimit postar në AKBPM. Regjistrimi i këtyre të dhënave në sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore bëhet nga specialistët e këtij institucioni.

Nga auditimi u konstatua se regjistrimi i cmimeve CIF kryhet në mënyrë manuale për barnat e regjistruara. Ky proces është i vazhdueshëm gjatë vitit deri në popullimin të plotë të çmimeve për çdo bar. Të dhënat e printuara dhe dërguar në rrugë shkresore nga MSHMS në AKBPM janë gjeneruar nga një dokument elektronik, por nga auditimi u konstatua se nuk është bërë i mundur importimi elektronik për këto të dhëna në sistem, çfarë minimizon gabimet njerëzore gjatë regjistrimit, veprimet e dyfishta për regjistrimin e tyre si dhe kohën jo efektive të punonjësve të angazhuar me regjistrimin në AKBPM.

Nga auditimi u konstatua se në fund të vitit Ministria e Shëndetësisë si institucion monitorues i AKBPM-ës, kërkon një raport përmbledhës të populluar me informacion për:

1. Emrin tregtar
2. Form Doza
3. Principi aktiv
4. Paketimi (çdo paketim i ndarë)
5. Mbajtësi i autorizimit për tregtim

6. Prodhuesi
7. Urdhri i ministrit/Data
8. O-XH Origjinator Xhenerik
9. CIF (në euro, në lek, në USD)
10. Import euro, në lek, në USD
11. Rimbursimi
12. Marzh pakice
13. Marzh Shumice

Raportimi i kërkuar nuk gjenerohet aktualisht nga sistemi por plotësohet për çdo të dhënë manualisht, çfarë vjen si rezultat i vonesës së regjistrimit të cmimeve që përcillen vazhdimisht në rrugë shkresore i cili përfshin afërsisht 4000 barna për të cilat numri rendor rritet nga ndarja e paketimeve si dhe mungesës së zhvillimit të sistemit për plotësimin e informacionit për dy fushat “Marzh pakice” dhe “Marzh Shumice” nuk kanë qenë parashikuar si të dhëna që duhet të regjistrohen në sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Nga auditimi u konstatua se mungesa e importimit elektronik për të dhënat që komunikohen në rrugë shkresore nga MSHMS sjellin vonesa në plotësimin dhe raportimin e gjeneruar nga sistemi. Importimi i të dhënave elektronike minimizon gabimet njerëzore gjatë regjistrimit, veprimet e dyfishta për regjistrimin e tyre si dhe kohën jo efektive të punonjësve të angazhuar me regjistrimin në AKBPM, për të dhënat e printuara dhe dërguar në rrugë shkresore nga MSHMS në AKBPM janë gjeneruar nga një dokument elektronik.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 “Mbi Projektin e Raportit e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: “Në lidhje me rekomandimin nr. 11.1, na lejoni të bëjmë me dije se për çdo procedurë të realizohet nga AKSHI, në çdo rast pjesë e grupit të punës të hmtimit të termave janë përfaqësuesit të institucionit që caktohen zyrtarisht. Roli i përfaqësuesve të institucionit është pikërisht për të adresuar kërkesat funksionale dhe administrative që ka institucioni përfitues. Në çdo rast, të gjithë kërkesat e institucionit akomodohen në terma të referencës, ashtu sikur ka ndodhur dhe në rastin e AKBPM. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se në kuadër të kontratës aktuale të mirmbajtjes Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore mund të adresojë çdo kërkesë që ka për shtimin e fushave në sistem apo reflektim të ndryshimeve të tjera të nevojshme. Në këto kushte, nisur nga sa me sipër konstatimi i grupit nuk qendron pasi dy elementet janë të realizuara në të kaluarën dhe aktualisht nga ana e AKSHI-t”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni juaj është pranuar pjesërisht, duke reflektuar ndryshime në formulimin e tij, meqenëse kjo kërkese mund të realizohet me kontratën aktuale.

Përdoruesit e bazës së të dhënave dhe të drejtat e tyre. Së bashku me kërkesën për përdoruesit e sistemit u kërkuar dhe përdoruesit e bazës së të dhënave që aksesojnë këtë sistem. Nuk kemi marrë asnjë informacion për përdoruesit e bazës së të dhënave dhe të drejtat e tyre, me gjithë komunikimet e vazhdueshme drejtuar AKBPM, e cila në mungesë të stafit kërkesën ia drejtoi MSHMS si dhe OE Data Log, që mirëmban sistemin informatik.

Nga auditimi u konstatua se, në kushtet kur sistemi i regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore nuk është konsideruar si një bazë të dhënash shtetërore si dhe në mungesë të një punonjësi me detyrat specifike të monitorimit të të dhënave dhe aksesimit të tyre në nivel përdoruesish dhe databaze, mbrojtja e të dhënave nuk është një proces i nisur.

Gjatë vëzhgimeve të veprimeve të ndryshme në sistem u konstatuan disa rekorde me user Implementer, të cilin punonjësit deklaruan se është përdorues i OE që ofron mirëmbajtjen. Nga auditimi u konstatua se testimet nga ana e OE Data Log janë zhvilluar në sistemin Live, por asnjë punonjës në AKBPM nuk kishte dijeni se si OE akseson të dhënat, kush e lejon këtë akses pasi nuk jepet prej tyre, mënyrën se si i akseson dhe sa të drejta disponon mbi këto të dhëna. Kjo do të thotë se OE ka akses të pakufizuar në të dhënat e këtij sistemi dhe integriteti i tyre është në mirëbesim dhe i parregulluar me asnjë akt ligjor.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 478/4, datë 29.06.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i AKSHI-t dërguar me shkresën nr.3681/1, datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.478/6, datë 09.09.2024: "Në lidhje me rekomandimin nr. 12.1, na lejoni tju bejme me dije se ashtu sikurse grupi është në dijeni, për permiresimin dhe mirëmbajtjen e sistemit është lidhur kontrata nr. 11 date 08.06.2022 me objekt "Permiresimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore për AKBPM". Në përcaktimet e kësaj kontrate parashikohen nderhyllje korrigjuese dhe parandaluese si dhe zhvillime sipas kërkesës së autoriteti përfitues. Gjithashtu në kontrate por edhe në udhezimin nr.30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik" parashikohet që çdo kontrate monitorohet nga një grup pune të cilet kanë pikerisht detyrë që të zbatohet kontrata me përpikëri dhe të mos realizohet asnjë veprim jashtë kontrate. Në këto kushte grupi i punës merr masa që operatori ekonomik të kryejë veprime në sistem në përputhje me kontratën në fuqi dhe nuk kryen asnjë veprim pa prezencën dhe miratimin e ndjekësve të kontratës. Bejme me dije se nuk është raportuar asnjë rast i shkeljes së detyrimeve kontraktuale nga operatori ekonomik, për këtë arsye konstatimi nga grupi i auditimit nuk qëndron pasi nuk na rezulton asnjë evidence për këtë çështje".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Asnjë punonjës në AKBPM nuk ishte në dijeni për aksesin që i jepet OE në sistem, për ndërhyrje korrigjuese apo parandaluese. Në kushtet kur AKSHI nuk është administrator i të dhënave, por lejon aksesimin e tyre nga palë të treta nevojitet të sigurojë dhe dokumentojë çdo gjurmë të çdo veprimi që të jetë i auditueshëm dhe i verifikueshëm.

Ky observacion nuk merret në konsideratë.

IV. REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka një akt krijimi të bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), që do të thotë se nuk është bërë një identifikim i të dhënave parësore të këtij sistemi, si dhe të dhënave dytësore që nevojiten për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij. Për këtë bazë të dhënash, nuk janë përcaktuar sipas nenit 4 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”:

- a) institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore;
- b) të dhënat parësore dhe dytësore;
- c) dhënësin/dhënësit e informacionit;
- ç) ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;
- d) nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.

Nga auditimi u konstatua se AKSHI, me kërkesat e specifikimeve teknike për përmirësimin e Sistemit të Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), ka kërkuar dhe ndërtuar ndërveprime me 6 sisteme të tjera, ku pjesa më e madhe njihen si baza të dhënash shtetërore. Këto ndërveprime të kërkuara dhe të ndërtuara mbi këtë sistem janë në kundërshtim me VKM nr.945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, neni 9/pika 5, ku citohet se: “Një bazë të dhënash shtetërore, e cila nuk është e regjistruar në Autoritetin Rregullator Koordinues-ARK, nuk vihet në përdorim dhe as ndërvepron me të tjera baza të dhënash shtetërore.”
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucioni koordinator për bazat e të dhënave shtetërore, të marrë masa për përgatitjen dhe miratimin e një akti nënligjor VKM, për krijimin e bazës së të dhënave për Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), në bashkëpunim me AKBPM, ku të përcaktohen të dhënat parësore dhe dytësore, burimet e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Infrastruktura *Software* dhe *Hardware* ku është ngritur Sistemi i Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), deri në fund të vitit 2022, ka qenë e konsideruar Infrastrukturë Kritike e informacionit, bazuar në VKM nr. 553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, që i përket periudhës objekt auditimi. Me hyrjen në fuqi të ndryshime me VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, sistemi tashmë i përmirësuar me emrin “Sistemi i Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, nuk rezulton të jetë në listën e infrastrukturave kritike apo të rëndësishme të informacionit, megjithëse rëndësia e tij është e lartë nisur nga fakti që cenimi apo shkatërrimi i tij do të kishte impakt serioz në shëndetin e qytetarëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit t’i kërkojnë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë

Kibernetike - AKSK, të bëjë ndryshimet përkatëse në VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, duke riklasifikuar si Infrastrukturë Kritike të Informacionit “Sistemin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB)”, duke marrë parasysh rëndësinë që ky sistem ka në shëndetin e qytetarëve. Me klasifikimin e duhur nevojitet të përmirësohen masat e sigurisë, të zbatohen protokolle të avancuara për mbrojtjen e të dhënave dhe të trajnohet vazhdimisht personeli për menaxhimin e situatave emergjente dhe kërcënimeve kibernetike.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nuk ka strukturë të posaçme (sektor TIK) apo punonjës IT në organikën e saj, të cilët kanë fushën e ekspertizës në çdo sistem dhe infrastrukturë *hardware* dhe *software* në fushën TIK të institucionit. Për më tepër, pranë AKBPM, aktualisht, nuk ka asnjë specialist IT të atashuar nga AKSHI që prej fundit të Qershorit 2023, duke vështirësuar përmbushjen e detyrimeve në fushën TIK. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të AKBPM-së dhe korrespondencës zyrtare AKBPM – AKSHI, nga muaji korrik 2023 e deri në periudhën e kryerjes së auditimit korrik 2024, nuk ka një asistencë teknike të atashuar nga AKSHI për Agjencinë. AKSHI i ka komunikuar AKBPM-së se ka kryer shpalljen e vendit vakant përcjellë me shkresën nr. 3361/7 prot., datë 16.11.2023, për përmbushjen e nevojave për burime njerëzore pranë AKBPM. Shkresa e fundit është me nr.1894 prot., datë 16.05.2024 ku kërkohet sërish nga ana e AKBPM-së caktimi i një punonjësi IT për periudhën tranzitore deri në plotësimin e vendit vakant. Mosplotësimi i vendeve vakante dhe punonjësve në një fushë kyçe si IT mbart riskun e lartë të mospërmbushjes së objektivave dhe misionit për të cilin është ngritur institucioni i AKBPM.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për caktimin e një punonjësi të Teknologjisë së Informacionit për të mbuluar nevojat e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore deri në plotësimin e vendit vakant të shpallur.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKBPM nuk është informuar nga AKSHI për manual/udhëzues mbi sigurinë e informacionit, me objekt përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësi për veprimet që lidhen me sigurinë me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aseteve të informacionit në institucion. Siguria e informacionit është një çështje që kërkon një bashkëpunim të ngushtë midis AKBPM-së dhe AKSHI-t. Edhe pse infrastruktura TIK dhe politikat e sigurisë së informacionit janë përgjegjësi primare e AKSHI-t, sikurse përcakton dhe neni 27 i Ligjit nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, është thelbësore që AKBPM të ketë një rol aktiv në këtë proces për të siguruar që të gjitha kërkesat specifike të sigurisë për informacionin që administrojnë të jenë të përmbushura. Në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 26, të Ligjit nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, AKSHI administrojnë nga ana teknike sistemin informatik të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve përkatëse. Mungesa e manualeve dhe udhëzuesve mbi sigurinë e informacionit, që kërkohet të përmbushet nga AKBPM, rrit

ndjeshëm riskun për incidente sigurie, siç janë akseset e paautorizuara, humbja ose komprometimi i të dhënave, si dhe mungesa e përgjegjësisë së qartë për veprimet e sigurisë, duke cenuar integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e aseteve të informacionit në AKBPM.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucioni qendror për administrimin e infrastrukturës *hardware* dhe *software* dhe shërbimeve të ndryshme në fushën TIK, të marrë masa për të hartuar rregulla specifike për sigurinë e informacionit në AKBPM.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKBPM nuk ka asnjë regjistër risku ku të ketë identifikuar risqet e lidhura me sigurinë e informacionit dhe objektivat e tij. Kjo mungesë e dokumentacionit e bën të pamundur vlerësimin e efektivitetit të kontroleve ekzistuese dhe planifikimin e masave të nevojshme për përmirësimin e sigurisë. Për rrjedhojë, subjekti mbetet i ekspozuar ndaj risqeve të paidentifikuara dhe të pamenaxhuara. Standardi ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001:2013 kërkon që institucionet të kryejnë një vlerësim të risqeve të sigurisë së informacionit dhe të mbajnë një regjistër të tyre. Kjo ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve në mënyrë sistematike dhe të dokumentuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për të krijuar dhe menaxhuar një regjistër të risqeve IT për infrastrukturën dhe sistemet që administrojnë për llogari të AKBPM-s, duke përfshirë risqet e lidhura me ato organizative, burimeve njerëzore, fizike dhe teknologjike.

Ndërsa, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të marrë masat e nevojshme për të siguruar përfshirjen e risqeve specifike për të dhënat dhe proceset e saj që kryen në sistemin informatik SIRKB, në regjistrin e përgjithshëm institucional.

Brenda vitit 2025 dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se transferimi kapital për infrastrukturën *Hardware* dhe *Software* është përcjellë nga AKBPM tek AKSHI me shkresën nr. 3227/25 prot., datë 23.02.2023. Megjithatë, nga ana e AKBPM-së përpara transferimit kapital dhe nga ana e AKSHI-t pas këtij transferimi, nuk ka gjurmë dokumentimi nëse konfigurimet e ndryshimeve të sistemeve janë të autorizuara, testuara dhe kontrolluara, në mënyrë që sistemet të vazhdojnë të mbështesin operacionet e institucionit sipas planit dhe në mënyrë që të gjitha gjurmët të dokumentohen. Një ndryshim i paaprovuar ose aksidental mund të ketë risqe të ndryshme dhe pasoja financiare për institucionin, sikurse përcakton dhe Standardi ISO 27001 dhe praktikat më të mira në fushën e sigurisë së informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për të krijuar dhe zbatuar një proces të gjurmueshëm për menaxhimin e ndryshimeve në Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB) konform standardit ISO27001:2022.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKBPM nuk ka dijeni për listën e përdoruesve të brendshëm, të jashtëm dhe të bazës së të dhënave të Sistemit të Informacionit të

Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB), të drejtat e tyre, si dhe akseset specifike për secilin prej tyre. Ky informacion u kërkua tek struktura IT e AKSHI-t, vendosur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët gjithashtu, nuk kishin dijeni. Mungesa e këtij informacioni dhe kontrolli cenon integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave që ruhen në sistemin informatik të barnave dhe pajisjeve mjekësore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për të ndërtuar procese kontrolli dhe monitoruar nëpërmjet tyre krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e aksesit në sistemin informatik të përdoruesve të brendshëm, si dhe atyre me akses në bazën e të dhënave. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të marrë masa për të siguruar informacionin e nevojshëm mbi përdoruesit që janë punonjës të institucionit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave (SMK) nuk është plotësuar plani i zbatimit të kontratës me nr.11, datë 08.06.2022 “Përmirësimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për AKBPM”, në kundërshtim me:

- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin2/pika L, i ndryshuar;
- Udhëzimin nr.2, datë 18.03.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi Raportimin e Zbatimit të Kontratës dhe formularit për zbatimin e kontratës.

Mungesa e këtij dokumenti jo vetëm që është në kundërshtim me kriteret ligjore përmendur më sipër, por pengon procesin e monitorimit sipas treguesve specifike të monitorimit të kontratës. Me rekomandimin nr.6858, datë 07.10.2022 mbi mënyrën e hartimit të formularëve të zbatimit të kontratës, APP rekomandon hartimin e planit të zbatimit të kontratës nga personat përgjegjës për ndjekjen e saj të caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 16-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor për kontratën me nr.11, datë 08.06.2022 “Përmirësimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për AKBPM”, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit të zbatimit të kontratës, një dokument i cili nënshkruhet ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik të kontraktuar për këtë shërbim. Ky dokument i shërben palëve, për të monitoruar nëse kontrata përmbushet në vlerën, kohën, sasinë dhe cilësinë e kushteve të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Plani i zbatimit të kontratës nevojitet të jetë në sistemin e menaxhimit të kontratave, në dispozicion të grupit ndjekës të kontratës të caktuar në bashkpunim me AKBPM.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me nr.11, datë 08.06.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për AKBPM”, lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe Operatorit Ekonomik me afat mirëmbajtjeje 24 muaj, u konstatuan çështjet si:

- Në asnjë rast nuk është respektuar afati 3 ditor përcaktuar në kushtet e vecanta neni 10/pika 10.1, të kontratës nr.11, datë 08.06.2022, ku në disa raste shërbimi i mirëmbajtjes është marrë në dorëzim pas më shumë se 1 muaj.
- Raportimet apo komunikimet e ndryshme realizohen jashtë sistemit të menaxhimit të kontratave me email ose telefon, duke e bërë të pagjurmueshëm kohën dhe cilësinë mbi zgjidhjen e problemit të raportuar.

- AKBPM nuk ka kryer pagesën e shërbimit të mirëmbajtjes për periudhën 23.05.2023 – 24.06.2023, për arsye se mungon nënshkrimi elektronik i një prej ndjekësve të kontratës, kur 3 anëtarët e tjerë e kanë nënshkruar marrjen e këtij shërbimi. AKSHI ka ndryshuar ndjekësin e kontratës, por nënshkrimi në sistem nuk është kryer nga anëtari i larguar dhe as nga anëtari i caktuar më pas. Mungesa e kësaj pagese rrit riskun për penaltite ose mosofrim shërbimi nga OE.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 16-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor për kontratën e shërbimit për Sistemin e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ku Autoritet Përfitues është AKBPM dhe në kushtet kur kjo kontratë përfundon në vitin 2024, të marrë masa që:

- Të rishikojë afatin 3 ditor për marrjen në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes i cili nuk është respektuar dhe nga vetë punonjësit e Autoritetit Kontraktor.
- Të kërkojë mjete monitoruese për ngarkimin e çështjeve/problematikave ku ndjekësit e kontratës nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Përfitues si dhe Operatorit Ekonomik, të mund të adresojnë problematikat që dalin gjatë ndjekjes së kontratës, një praktikë kjo e vlefshme e ndjekur në raste të tjera që janë konstatuar nga auditimi.

Në vijimësi

7.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të marrë masa për të kryer pagesën e mirëmbajtjes për periudhën 23.05.2023–24.06.2023, me qëllim parandalimin e një penalteti ose mosofrim shërbimi nga OE, në kushtet kur 3 anëtarët e tjerë kanë nënshkruar marrjen në dorëzim të shërbimit për periudhën e sipërcituar dhe për më tepër nuk është raportuar asnjë mangësi nga ndjekësit e kontratës në ofrimin e këtij shërbimi brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Brenda vitit 2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin udhëzues për ndërtimin dhe funksionimin e sistemit, u konstatua se:

- Nuk ka një dokumentim për manualin e sistemit, për përdoruesit e brendshëm që janë punonjës të AKBPM-ës;
- Kriteret e aplikuar në sistem për fjalëkalimin e përdoruesve janë minimaliste. Nga testimet rezultoi se fjalëkalimi kërkon minimumi 5 karaktere dhe nuk janë aplikuar kriteret për përmbajtjen dhe vlefshmërinë;
- Nuk janë përcaktuar të drejtat administrative të të dhënave të këtij sistemi, ndërkohë që AKSHI pretendon se siguron vetëm administrimin nga ana teknike të çdo sistemi TIK dhe AKBPM nuk ka asnjë strukturë të dedikuar për administrimin e të dhënave në Sistemin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- Nuk ka një gjurmë dokumentimi mbi aksesin që i është dhënë dhe i jepet në vazhdimësi OE që ka zhvilluar dhe aktualisht mirëmban Sistemin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, çfarë përbën një risk tek siguria e të dhënave, konfidencialitetit dhe gjurmimi i incidenteve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa që OE të:

- vendosë në dispozicion manualin e sistemit për përdoruesit e brendshëm që janë punonjës të AKBPM-së;

- implementojë praktika të fjalëkalimeve të forta, që përmbajnë një kombinim të shkronjave të mëdha dhe të vogla, numrave dhe simboleve speciale dhe një gjatësi minimale prej 12 karakteresh;

- kërkojë automatikisht ndryshimin periodik të fjalëkalimeve dhe të ndalojë përdorimin e fjalëkalimeve të përdorura më parë, me qëllim rritjen e nivelit të mbrojtjes kundër aksesit të paautorizuar dhe përmirësimin e sigurisë së përgjithshme të sistemeve kritike.

Brenda vitit 2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në ndërveprimet e sistemeve nuk është parashikuar ndërveprimi me sistemin doganor, ku:

- Autorizimi për import që aprovon AKBPM i dërgohet subjektit në llogarinë e tij në e-albania, dokument të cilin vetë subjekti e paraqet gjatë procesit të zhdoganimit.

- Deklarata Doganore i jepet subjektit në zhdoganim, një dokument të cilin subjekti ja paraqet inspektorëve të AKBPM në aktet e inspektimit.

- Certifikatë regjistrimi si dokument që shërben për importimin e pajisjeve mjekësore.

Komunikimi i munguar ndërmjet sistemit të doganave dhe atij të barnave dhe pajisjeve mjekësore, bën që të jetë subjekti në të dy rastet ai që dorëzon dokumentin në doganë mbi autorizimin e marrë nga AKBPM dhe dokumentin e zhdoganimit tek inspektorët e AKBPM, çfarë përbën një risk në ndryshimin e të dhënave dhe pamundësinë për të vërtetuar ndryshimet në përmbajtjen e tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e krijuesit, zhvilluesit dhe administruesit të sistemeve dhe i infrastrukturave të marrë masa për të implementuar ndërveprimin midis Sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Sistemit Doganor me qëllim automatizimin e komunikimit dhe integrimin e informacionit në kohë reale, duke eliminuar nevojën që subjekti të dorëzojë manualisht dokumentet si një masë parandaluese që redukton riskun nga ndryshimet e mundshme në të dhëna dhe siguron një proces më të saktë dhe të efektshëm për autorizimin dhe zhdoganimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në ndërveprimet e sistemeve nuk është parashikuar ndërveprimi me sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për autorizimin për import të barnave narkotike, lëndët psikotrope dhe barnat e paregjistruara, për të cilat AKBPM vepron me autorizimin e zhdoganimit. Aktualisht ky komunikim mundësohet nëpërmjet subjektit, i cili dokumentin e marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nëpërmjet eAlbanias, e ngarkon po në eAlbania në aplikimin që kryen për autorizim zhdoganimi tek AKBPM, çfarë përbën një risk në ndryshimin e të dhënave dhe pamundësinë për të vërtetuar ndryshimet në përmbajtjen e tyre.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se regjistrimi i cmimeve CIF kryhet në mënyrë manuale për barnat e regjistruara. Ky proces është i vazhdueshëm gjatë vitit deri në popullimin të plotë të çmimeve për çdo bar. Të dhënat e printuara dhe dërguar në rrugë shkresore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në AKBPM janë gjeneruar nga një dokument elektronik, por nga auditimi u konstatua se nuk është bërë i mundur importimi/transferimi elektronik për këto të dhëna në sistem, çfarë krijon mundësinë për gabime njerëzore gjatë regjistrimit, veprime të dyfishta për regjistrimin e tyre si dhe kohën jo efektive të punonjësve të angazhuar me regjistrimin në AKBPM.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e krijuesit, zhvilluesit dhe administruesit të sistemeve dhe infrastrukturave të marrë masa për të implementuar ndërveprimin ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, në lidhje me:

- autorizimet e importit të barnave narkotike, lëndëve psikotrope dhe barnave të peregjistruara, çfarë përbën një risk në ndryshimin e të dhënave dhe pamundësinë për të vërtetuar ndryshimet në përmbajtjen e tyre;
- importimin/transmetimin e të dhënave elektronike që aktualisht përcillen në AKBPM me dokument shkresor, çfarë krijon mundësinë për gabime njerëzore gjatë regjistrimit, veprime të dyfishta për regjistrimin e tyre si dhe kohën jo efektive të punonjësve të angazhuar me regjistrimin në AKBPM.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në sistemin informatik nuk është i mundur plotësimi i informacionit për dy fushat “Marzh pakice” dhe “Marzh Shumice”, të cilat nuk kanë qenë parashikuar si të dhëna që duhet të regjistrohen në sistemin e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, por janë të dhëna që kërkohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fund të vitit si institucion monitorues i AKBPM-ës. Kjo kërkesë përmban një raport përmbledhës të populluar me informacion për: emrin tregtar, form doza, principi aktiv, paketimi (çdo paketim i ndarë), mbajtësi i autorizimit për tregëtim, prodhuesi, urdhri i ministrit/data, origjinator xhenerik, CIF (në euro, në lekë, në usd), import (euro, lek, usd), rimbursimi, marzh pakice dhe marzh shumice.

Raportimi i kërkuar nuk gjenerohet aktualisht nga sistemi, por plotësohet për çdo të dhënë manualisht, çfarë vjen si rezultat i vonësës së regjistrimit të cmimeve që përcillen vazhdimisht në rrugë shkresore ku përfshihen afërsisht 4000 barna për të cilat numri rendor rritet nga ndarja e paketimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në cilësinë e Autoritet Përfitues si dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si institucioni që monitoron agjencinë nëpërmjet raportimeve specifike, në kuadër të kontratës së mirëmbajtjes, ti kërkojnë Operatorit Ekonomik shtimin e fushave që nevojiten të popullohen me të dhëna gjatë regjistrimit.

Brenda vitit 2024

12. Gjetje nga auditimi: Në kushtet kur sistemi i regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore nuk është konsideruar si një bazë të dhënash shtetërore si dhe në mungesë të një punonjësi me detyrat specifike të monitorimit të të dhënave dhe aksesimit të tyre në nivel përdoruesish dhe databaze, mbrojtja e të dhënave nuk është një proces i nisur në AKBPM dhe në përputhje me nenin 26/pika c, të ligjit nr.43/2023 “Për qeverisjen elektronike”.

Gjatë vëzhgimeve të veprimeve të ndryshme në sistem u konstatuan disa rekorde me user Implementer, të cilin punonjësit deklaruan se është përdorues i OE që ofron mirëmbajtjen. Testimet nga ana e OE Data Log janë zhvilluar në sistemin Live, por asnjë punonjës në AKBPM nuk kishte dijeni se si OE akseson të dhënat, kush e lejon këtë akses pasi nuk jepet prej tyre, mënyrën se si i akseson dhe sa të drejta disponon mbi këto të dhëna, që do të thotë se OE ka akses të pakufizuar në të dhënat e këtij sistemi, çfarë përbën një risk të lartë për arsye se integriteti i të dhënave nuk mund të sigurohet në mirëbesim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 24-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në cilësinë e Autoritet Përfitues, të marrin masa për ndalimin e testimeve në sistemin Live që kryen OE i cili mirëmban Sistemin e Regjistrimit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Gjithashtu, të merren masa për monitorimin dhe dokumentimin e aksesit që i jepet OE në sistem, sa herë që lind nevoja për veprime ose mirëmbajtje. Ky monitorim duhet të përfshijë regjistrimin e çdo aktiviteti të OE, përfshirë hyrjet, ndërhyrjet dhe ndryshimet që bëhen në sistem. Dokumentimi duhet të jetë i detajuar dhe i ruajtur në mënyrë që të mund të auditohet dhe të verifikohet integriteti i të dhënave. Për këtë duhet të krijohen protokolle të qarta për autorizimin e aksesit dhe për të siguruar që çdo akses i OE është në përputhje me rregullat dhe nëse është dhënë nga personat përgjegjës, duke ndihmuar kështu në mbrojtjen e sigurisë dhe integritetit të sistemit.

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT